



P.nr.32/2017

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NE GJILAN** – Dega në Novobërdë- Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm Hasan Sadiku, me zyrtare ligjore Emine Shkodra, në lëndën penale të akuzuarit Sh. Z. nga fsh. Komuna Novobërdë, për shkak të veprës penale, Lidhje e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjiçan, Departamenti i përgjithshëm PP.II.nr.763/2017 dt. 10.05.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më dt.25.09.2017 në prani të Prokurorës të shtetit Bahtije Ademi, të akuzuarit, ndërsa me 26.09.2017 publikishtë shpalli këtë :

### AKT GJYKIM

I akuzuari Sh. Z., pa pseudonim dhe emër të rrejtshëm nga i ati H. dhe nëna H., e lindur Mustafa, i lindur më dt. 10.10.1954 në Fsh. Pr. Komuna e Prishtinës, tani me vendbanim në Fsh. Komuna, ka të kryer shkollën tetë vjeqare, i pa punë, i martuar, baba i tre fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë, dhe kinse i nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tijë.

### ËSHTË FAJTORË

Sepse me datën 15.12.2017, në shtëpinë e tijë, në Fsh. Komuna e Novobërdës, i pandehuri, ka bërë lidhje direkte në rrjet elektrik jashtë orëmatësit, për plotësimin e nevojave të veta me energji elektrike pa njëisor elektrik, pa autorizimin e, me qëllim të shmangëjes së pagesës të energjisë së shpenzuar elektrike, me ç'rast të dëmtuares EES-Distribucioni në, i ka shkatuar dëm në shumën prej **219.68 euro**.

Me çka ka kryer veprën penale Lidhje e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-ës.<sup>1</sup>

<sup>1</sup> KODI NR. 04/L-082 /KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 41,46, 51,52 ,55 dhe 73 të KPRK-së<sup>2</sup>, si dhe neni 365 të KPPRK-së<sup>3</sup> e gjykon me ,

### **Denim me kusht**

Me denim me burgim në kohë zgjatje prej 4(katër) muajve, dhe denim më gjobë në shumën prej 200€(dyqindë euro), të cilët denime nuk kan për tu egzekutuar nëse i akuzuari në afat prej 1(nji) viti nga dita e plotfuqishmëris së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonji vepër tjetër penale, në të kundërtën denimet kan për të revokuar.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llgoarisë përfundimtare të kësaj gjykate dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20(njëzet) euro.

E dëmtuara / i i Distribuimi , për ralizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

### **Arsyetim**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.763/2017 dt. 10.05.2017, e ka akuzuar Sh. Z. nga fshati Koznicë, Komuna Novobërdë, për veprën penale Lidhje e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-ës .

Prokurorja e shtetit Bahtije Ademi, në seancën fillestare deklaroi se mbetet pranë aktakuzës së ngritur me shkrim, dhe propozoi që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim meritore sipas kodit penal.

Prokurorja e shtetit deklaroi se e pranoi pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit, sepse aktakuza është mbështetur në provat materiale të cilat gjindet në shkresat e lëndës dhe se i akuzuari nga ana e gjyqtarit është njoftuar për pasojat dhe favoritet e pranimit të fajsisë.

Meqenëse i akuzuari Sh. Z. , në shqyrtimin fillestar të kësaj çështje penale e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, e me këtë, sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjendja faktike në këtë çështje penale nuk është kontestuese, sepse përpos pranimit të fajësisë nga ana e vet të akuzuarit, një pranim i tillë i fajësisë ka mbështetje në provat e grumbulluara që gjenden në shkresat e lëndës se i akuzuari vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, se i akuzuari

<sup>2</sup> KODI NR. 04/L-082 /KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

<sup>3</sup> Kodi Nr. 04/L-123 /KODI I PROCEDURES PENALE I REPUBLIKËS SË KOSOVËS



e ka kuptuar natyrën dhe pranimin e fajit, dhe se aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata i pati parasysh të gjitha rrethanat sikurse ato lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në përcaktimin e dënimit në pajtim me nenet 45 dhe 46 të KPRK-ës<sup>4</sup>, dhe kështu si rrethana lehtësuese të akuzuarit gjykata ia mori për bazë sjelljen e tij korrekte gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, pranimin e fajësisë dhe pendimin për të njëjtën, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale, gjendjen e tij ekonomike dhe familjare, se është i martuar, pensioner, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së varfër ekonomike, dhe në mungesë posaqërisht të ndonjë rrethane rënduese, të njëjtit i shqiptoi dënimin me si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me ligj në mënyrë që i akuzuari në të ardhmen mos të kryejë vepër tjetër penale por që me një dënim të tillë të ndikohet edhe tek të tjerët për të mos kryejë vepra tjera penale.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale është marrë në bazë të nenit 450 të KPPRK-ës.<sup>5</sup>


Nga të cekurat e mësipërme e në bazë të nenit 365 të KPPRK-ës,<sup>6</sup> u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NË NOVOBËRDË

Më dt. 26.09.2017

Zyrtare ligjore,

Emine Shkodra, d.v.



Gjyqtari,

Hasan Sadiku, d.v.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Ankesa ushtrohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate.



<sup>4</sup> KODI NR. 04/L-082 /KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

<sup>5</sup> Neni 450 - Lloji i shpenzimeve të procedurës penale-Kodi Nr. 04/L-123 /KODI I PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

<sup>6</sup> Neni 365/ Aktgjykimi fajësues/ KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS